

PASOJAT NGATIVE TË HUMBJES SË SHPRESËS

VULLNET MERJA

Humbja e shpresë nga mëshira dhe falja e Allahut të Madhëruar është njësoj si mohimi i Tij. Allahu i Madhëruar në suren “Zumer”, ajeti 53 thotë: **“Thuaj: “O robtë e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.”**

Ky ajet na sqaron se portat e mëshirës së Allahut janë të hapura për gjynahçarët dhe mëkatarët. Ajeti këta i nxit gjynahçarë e mëkatarë që ta harrojnë të shuarën dhe të hapin një faqe të re me Allahun e Madhëruar dhe Fuqiplotë. Me një thënie të ëmbël e të mbushur me dhembshuri, dashuri dhe butësi, Allahu hap dyert e mëshirës së Tij për të gjithë gjynahçarët dhe vendos që t’i falë ata.

Po të thellohemi më shumë në fjalët e këtij ajeti do të vërejmë se ky ajeti është më i qarti që u jep shpresë të gjithë gjynahçarëve, sado të mëdhaja të jenë gjynahet e tyre, për gjithpërfshirjen e këtij ajeti, prijësi besimtarëve, imam Aliu paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Nuk ka në Kur’an ajet më gjithpërfshirës se ajeti: **Thuaj: “O robtë e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.”**

Në këtë ajet Allahu i fton të gjithë gjynahçarët që e kanë ngarkuar veten e tyre me gjynahe të mëdhaja apo të vogla, siç janë: padrejtësia ndaj vetes dhe të tjerëve, lënia e dytarve dhe e obligimeve të caktuara nga Allahu si namazi, agjërimi, haxhi, zekati, khumsi (një e pesta), përgojimi, thashethemi, gënjeshtria, kamata, uzurpimi i pasurisë së tjetrit, etj, që të mos e humbasin shpresën te falja e Allahut.

“Thuaj: “O robtë e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut!...” O njeri, kurrë mos e humb shpresën nga mëshira e Allahut. Ji i bindur se Allahu i fal të gjitha gjynahet nëse pendohesh me pendim të sinqertë dhe kthesh në rrugën e Allahut. Duhet ta dishë se porta e pendimit dhe e kthimit tek Allahu është gjithmonë e hapur para teje. Sado që të jesh i njollosur e i përlyer me mëkate, ti ke mundësi ta pastrosh veten tënde nga këto mëkate me uin e pendimit të sinqertë dhe je ti ai që ken ë dorë të hapësh një faqe të re në jetën tënde dhe të

mbështesh tek Allahu i Plotfuqishëm. Kurrë mos thuaj se Allahu nuk më fal mua. Kurrë mos mendo dhe mos thuaj se porta e pendimit është e mbyllur për mua. Kurrë mos e përfytyro vetën tënde se ke arritur deri në atë gjendje sa nuk bën dobi pendimi dhe kthimi tek Allahu. Kurrë mos thuaj se unë nuk mund të çlirohem nga prangat e gjynaheve që kam bërë në jetën time. Kurrë mos ju nënshiro egos që të mashtron e të thotë se ty nuk të pranohet pendimi dhe se Allahu nuk të pranon. Sepse të gjitha këto thënie dhe këto përfytyrime janë vetë humbja e shpresës nga mëshira dhe falja e Allahut.

Nga njëra anë humbja e shpresës në mëshirën dhe faljen e Allahut është njësoj si mohimi (kufri). Nga ana tjetër, humbja e shpresës e shtyn njeriun që të bëhet kriminel dhe e shtyn që të bëjë edhe më shumë gjynahe. Kjo ndodh se ky njeri mbart ndienjën se nuk ka shpëtim për atë dhe as shpresë për të dalë nga errësira dhe nga llumi i gjyhaheve. Në und do të arrijë të thotë: Përderisa jam mëkatarë dhe nuk kam rrugëzgjdhje tjetër, për t'ia ndaloj vetes qejfet dhe kënaqësitë e kësaj jete?!

Hamid ibn Kahtabetu ka qenë oficer në ushtrinë e Harun Rrashidit. Përshak se ai humbi krejtësisht shpresën nga mëshira dhe falja e Allahut për gjynahet që kishte bërë, ai hoqi dorë nga të gjitha parimet dhe vlerat dhe nga të gjitha detyrat dhe obligimet e caktuara nga Allahu dhe filloi të bënte më shumë gjynahe dhe mëkate duke vrarë të pafajshëm dhe punëmirë.

Një nga shokët e imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!) një ditë ia përcjell imamit historinë e këtij këtij burri duke i thënë: “Në muajin e Ramazanit shkova tek Hamid ibn Kahtabetu dhe ai nuk e agjëronte. Unë i thashë atij: “A je i sëmurë?” Ai tha: “Jo.” I thashë: Ti nuk je udhëtar përse nuk e agjëron muajin e Allahut? Ai më tha: “Unë e di se Allahu kurrë nuk do më falë mua.” I thashë: “Çfarë ke bërë që Allau nuk të fal ty?” Ai mu përgjigj: “Një natë Harun Rrashidi më kërkoi dhe më tha: “Deri në ç’masë ti je me mua?” Unë i thashë: “Unë jam gati të flijoj për ty pasurinë time, vetin time dhe nderin tim.” Ai më tha: “Kjo nuk mjafton.” Pastaj unë u largova nga ai, tha ibn Kahtabetu. Kur po shkoja në shtëpi, Haruni më kërkoi përsëri dhe më tha: “Deri në ç’masë ti je me mua?” Unë i thashë: “Jam i gatshëm të të flijoj me fenë time.” Ai më tha: “Kjo është ajo që dua.” Pastaj më dha shpatën dhe më tha: “Zbato çdo gjë që do të të thotë ky djali.” Hamii tha: “Djali më mori dhe më çoi te dera një shtëpie. Ai hapi derën e një prej dhomave dhe në të ishin njëzet djem prej gjenezës së profetit Mugamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) të lidhur me pranga hekuri. Ata i sollli në mesin e shtëpisë në të cilën ndodhej një pus. Djali më urdhëroi t’ua pres atyre kokat dhe t’i hedh në pus. Unë ua preva kokat dhe hodha në pus. Më pas hapi derën e një dhome tjetër dhe në të ndodheshin disa sejida të burgosur nga gjeneza e Fatime

Zahrasë. Ati ishin të moshuar. Unë ua preva kokat dhe i hodha në pus. Një plak i moshuar me mjekër të bardhë më vështroi dhe më tha: “Nëse gjyshja ime Fatime Zahraja do të të pyesë ty në Ditën e Kijametit për shkakun e vrasjes time, si do t’i përgjigjesh? Aty mu drodhën gjymtyrët. Djali më vështroi dhe më urdhëroi t’ia pres kokën. Unë ia preva kokën dhe e hodha në pus. Për këtë shkak Allahu kurrë nuk do të më falë mua. Atëherë përse ta agjëroj? Transmetuesi thotë se imam Sadiku u pikëllua shumë nga kjo histori kur e dëgjoji. Pastaj tha: “Vërtet, mëkati i këtij që e humbi shpresën në mëshirën e Allahut është më i madh se mëkati i vrasjes së gjashtëdhjetë burave nga gjeneza e profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Pra, humbja e shpresë nga mëshira dhe falja e Allahut është mohim dhe ai njeri të cilin e mashtron shritani duke i pëshpëritur se për ty nuk ka shpresë për falje, ai jeri bëhet si hamid ibn Kahtabetu.

Vërte, humbja e shpresës nga mëshira dhe falja e Allahut e çon njeriun që të tejkalojë të gjitha normat etiko-morale dhe të shkelë të gjitha parimet dhe vlerat e larta humane dhe jerëzore. Ajo e zhyt atë në pellgun e qelbur të qejfeve dhe të pasioneve të ndaluara. Ndërsa të shpresuarit të mëshira dhe falja e Allahut, besimi dhe bindaj se Allahu është i Gjithmëshirëshëm dhe Falës dhe se Allahu ia fal njeriut gjynahet kur pendohet dhe bën punë të mira, padyshim që kjo shpresë e bën njeriun që të jetë sundues i epsheve dhe i egos së tij dhe të jetë triumfues në betejën e tij të brendshme, logjikë - ego nxitëse për të keq.

Prandaj o njeri. Mos hezito dhe mos humb kohë. Kthehu te Zoti yt, I cili thotë në Kur’an: “...**Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.**” (Sure “Bekare”, ajeti 222.)

Dhe: “**O ju, që keni besuar! Kthehuni tek Allahu me një pendim të sinqertë, që Zoti juaj t’ju shlyejë gabimet e t’ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, Ditën, kur Allahu nuk do ta turpërojë Profetin dhe ata që besuan bashkë me atë. Drita e tyre do të shkëlqejë para tyre dhe në të djathtë të tyre. Ata do të thonë: “O Zoti ynë, përsose dritën tonë dhe falna ne! Vërtet Ti je i Fuqishëm për çdo gjë.”** (Sure “Tahrim”, ajeti 8)